



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 37, datë 03.02.2023

**PËR**  
**MIRATIMIN E LISTËS SË KATËRMBËDHJETË TË 4 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË**  
**CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE**  
**INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS**  
**PROJEKTIT MODEL**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019; VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.8, datë 28.01.2021 “Për miratimin e kontratës model për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi” dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së katërbëdhjetë të 4 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model, pasqyruar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij, hartuar

nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.02.2023**



**ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA MASA E GRANTIT TË RINDËRTIMIT**

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R1	FATMIR	XHEVIT	SHEHU	7	3+1	3,428,958
2	R4	IANEME	XHEVIT	HOXHIA	4	2+1	2,617,558
3	ISHEM	BILAL	HAMID	MULLAHI	4	2+1	2,617,558
4	ISHEM	ZEJDI	ASLLAN	GEQA	2	1+1	2,236,552





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 108/ prot.  
14

Durrës, më 14 02 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

14/2/23 2614/3

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.37 datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së katërbëdhjetë të 4 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

